



Fakulteti i Ndërtimtarisë Raport Vjetor

Januar - Dhjetor
2021

HYRJE

Raport i punës i Fakultetit të Ndërtimtarisë për periudhën janar-dhjetor 2021.

Fakulteti i Ndërtimtarisë si njësi akademike e Universitetit të Prishtinës gjatë periudhës janar dhjetor 2021 ka zhvilluar një seri aktivitete të cilat mund të klasifikohen në aktivitete të rëndomta të funksionimit si dhe në aktivitete tjera të cilat kanë për qëllim përmbushjen e strategjisë së Universitetit të Prishtinës, përkatësisht të Fakultetit të Ndërtimtarisë sikur janë bashkëpunimet me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, organizimi i ligjëratave të hapura, tryezave të punës dhe të tjera.

Plani strategjik i zhvillimit të Fakultetit të Ndërtimtarisë për periudhën 2021-2023 është hartuar nga grupi i mësimdhënësve të rregullt të fakultetit, i njëjti është publikuar për debat të brendshëm publik në faqen elektronike të Fakultetit për periudhë një mujore dhe i njëjti është miratuar nga Këshilli i Fakultetit dhe është publik në faqen elektronike.

Cilësia e brendshme e Fakultetit të Ndërtimtarisë:

Procesi i mirëvajtjes së mësimdhënies në periudhën deri në maj 2021 (semestri veror) është zhvilluar në variantin virtual duke marr parasysh efektin e pandemisë dhe infeksioneve të COVID-19. Sipas shënimeve nga raportet e mësimdhënësve, mësimi në variantin virtual për periudhën 15 shkurt deri 31 maj 2021 janë mbajtur gjithsej 4284^h, që mesatarisht 8,16^h/ditë pune. Ndërsa semestri dimëror fillon punën me mësim me 15 tetor dhe deri në dhjetor mësimdhënësit e FN mbajnë 5463^h mësimi.

Tabela 1. Orët misimore të mbajtura nga stafi akademik i rregullt, nga Universiteti dhe i angazhuar për semestrin dimëror të vitit akademik 2020/2021 për periudhën janar-Maj 2021.


Orë mësimi të mbajtura nga stafi akademik				
Muaji	F1	F2	F3	F1+F2+F3
Shkurt	285	43	125	453
Mars	1192	111	392	1695
Prill	1065	121	333	1519
Maj	989	98	381	1468
Totali	3531	373	1231	5135

Gjatë kësaj periudhe të pandemisë janë marrë të gjitha masat nga Fakulteti që të respektohen vendimet e Institucioneve vendore, Këshillit Drejtues të UP-së, Senatit të UP-së dhe menaxhmenti i UP-së lidhur me respektimin e masave për mos shpërndarjen e virusit Covid 19, të menaxhuar edhe nga Task forca e themeluar në nivel të FN-së. Në raste të tilla njësia jonë ka organizuar provimet për studentët për afatet nga janari deri në dhjetor të 2021.

Tabela 2. Orët misimore të mbajtura nga stafi akademik i rregullt, nga Universiteti dhe i angazhuar për semestrin dimëror të vitit akademik 2021/2022 për periudhën tetor-dhjetor 2021.

Orë mësimi të mbajtura nga stafi akademik – semestri dimëror 21/22				
Muaji	F1	F2	F3	F1+F2+F3
Tetor	523	62	125	710
Nëntor	1368	200	328	1896
Dhjetor	1506	146	312	1964
Janar	671	60	162	893
Totali	4068	468	927	5463

Diplomimi i studentëve për periudhën raportuese sipas shënimeve nga raportet e dorëzuara konsiderohet tregues i arritshmërisë dhe përmban: 143 të diplomuar nga të gjitha programet e studimeve BSc dhe 30 të diplomuar nga të gjitha programet MSc.



Grafiku 1, studentët e diplomuar për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2021 në nivel të FN-së

Inventarizimi i sallave të mësimi me pajisje të konkretizimit, videoprojektor, tabela mësimi etj. është karakterizuese për këtë periudhë raporti, secila klasë mësimi posedon videoprojektorin. Laboratorët janë pajisur me materiale të nevojshme për realizimin e ushtrimeve me studentët në mënyrë të pa penguar.

Gjatë semestrit dimëror janë realizuar shumë vizita studimore me studentët nga mësimdhënësit në objekte dhe lokacione brenda Kosovës dhe kryesisht në Shqipëri.

Fakulteti ndanë mirënjohje për studentët e dalluar për çdo vit akademik. Edhe këtë vit janë shpallur studentët më të mirë sipas kriterëve: nota mesatare më e lartë (mbi notën 8) dhe nga një student nga secili program i studimit. Këta studentë, shënimet e tyre publikohen në faqen elektronike të Fakultetit.

Në mënyrë të rregullt, menaxhmenti i FN-së organizon takime me studentët si dhe me këshillin e studentëve të FN-së duke identifikuar nevojat si dhe kërkesat e tyre.

Edhe pse pjesa më e madhe e vitit karakterizohet me intensitet të rritur të infeksioneve (nga periudha në periudhë) nga Covid 19, administrata e Fakultetit është angazhuar në maksimum për punët e përditshme si dhe në raste edhe për punët e shtuara në varësi të nevojave të fakultetit sikur ishin organizimet e shumta që u bënë brenda vitit 2021.

Stafi akademik i Fakultetit të Ndërtimitarisë

Gjatë periudhës janar deri në shtator të vitit 2021, numri i stafit akademik me kontratë të rregullt 34, nga të cilët 19 janë mësimdhënës ndërsa 15 janë asistent. Kjo statistikë e stafit akademik të rregullt ndryshon nga tetori si rezultat i konkurseve të organizuara nga UP-ja, dhe gjithsej janë 36 mësimdhënës, nga të cilët 18 janë të mësimdhënës ndërsa 18 janë asistent. Brenda vitit 2021 është pensionuar një profesor, ndërsa nga pandemia Covid 19 vdes një profesor. Listës së mësimdhënësve i shtohet një profesor vizitor nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit i cili është i angazhuar për vitin akademik 2021/2022.


Tabela 3. Kategoritë e mësimdhënësve sipas arritjes së gradave shkencore

FAKULTETI I NDERTIMTARISE						
KATEGORIA E PROFESORËVE						
Gradat	A	B	C	D	E	
	Stafi me të gjitha gradat në UP	Stafi me së paku një gradë në Universitete të vendeve BE-së	Stafi me së paku një gradë në Universitete të SHBA	Stafi me së paku një gradë në Universitete tjera jashtë Kosovës	Stafi me grada të kombinuara nga kategoritë B, C dhe D	
Bsc	2				0	Total mesimdhënës
Msc						
PhD		3	0	13		
Total	2	3	0	13	0	
KATEGORIA E ASISTENTËVE						
Gradat	A	B	C	D	E	
	Stafi me të gjitha gradat në UP	Stafi me së paku një gradë në Universitete të vendeve BE-së	Stafi me së paku një gradë në Universitete të SHBA	Stafi me së paku një gradë në Universitete tjera jashtë Kosovës	Stafi me grada të kombinuara nga kategoritë B, C dhe D	
Bsc	14	0	0	0	0	Total asistent
Msc		0	0	2		
PhD		0	0	2		
Total	14	0	0	4	0	

Vërejtje: Stafi duhet të vendoset vetëm në njërin prej kategorive A,B,C,D ose E. Në total shifra duhet të përputhet me nurmin aktual të mesimdhënësve përkatësisht asistentëve në Fakultet

Stafi akademik i angazhuar brenda UP-së (F2) nga njësitë tjera akademike për semestrin verorë 2020/2021 janë gjithsej 10, ndërsa për semestrin dimëror të vitit akademik 2021/2022 janë gjithsej 14, nga të cilët 8 profesor dhe 6 asistent.

Stafi akademik i angazhuar me kontratë (F3), sipas konkursit, për semestrin verorë të vitit akademik 2020/2021 janë 23 mesimdhënës ndërsa për semestrin dimëror të vitit akademik 2021/2022 janë gjithsej 17 mesimdhënës.



Grafiku 2. Stafi akademik i FN (sipas angazhimeve F1, F2 dhe F3) për vitin 2021

Gjatë vitit 2021 është realizuar dhe përmbyllur konkursi “Për emërimin, rrimërimin dhe avancimin e personelit akademik në fakultetet e Universitetit të Prishtinës” për avancimin e tre mesimdhënësve (dy asistent rizgjedhje dhe një avancim nga asistent në Profesor asistent) dhe zgjedhjen e pesë mesimdhënësve të rregullt (katër asistent dhe një Profesor asistent).

Është përmbyllur konkursi “Për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjerata dhe ushtrime në bazë të nevojave të njësisë akademike të UP “Hasan Prishtina””, për vitin akademik 2021/22 nga Fakulteti i Ndërtimtarisë për 11 pozita (4 mesimdhënës, 1 lektore dhe 6 asistent).

Bashkëpunimet në nivel vendi dhe ndërkombëtarë të FN-së

Stafi akademik i Fakultetit përkatësisht Departamenti i Hidroteknikës në bashkëpunim me Menaxhmentin dhe administratën e Fakultetit janë mobilizuar për konkurrim në projekt për organizimin e programit të studimeve Master shkencorë për Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore në Kosovë. Të njëjtin projekt FN-ja e fiton dhe nënshkruhet Letër Marrëveshje (prot. FN nr 3330/1 të datës 21.10.2021), e lidhur ndërmjet Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” në Prishtinë-Fakulteti i Ndërtimtarisë në partneritet me Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë dhe Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe zbatohet nga Skat Consulting Ltd. (Zvicër) në konsorcium me Agjencinë e

Mjedisit të Austri (EAA), lidhur me programin studimor Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore në Kosovë. Ky projekt mbështet financiarisht në vlerën prej 150.000,00 € nga zyra Zvicerane.

Bashkëpunimet e FN-së me institucionet vendore dhe ndërkombëtare për këtë periudhë shënojnë përparime. Janë shumë marrëveshje të nënshkruara për bashkëpunim, sikur:

- Marrëveshja për bashkëpunimin e MKRS (Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit) të Kosovës me FN. Janë tre aneks marrëveshje ndërmjet MKRS dhe FN lidhur me vlerësimin e gjendjes së objekteve në kompleksin memorial “Adem Jashari” në Prekaz, vlerësimi i objektit të Muzeut Kombëtar të Kosovës.
- Marrëveshjet me të gjithë anëtarët e BI të FN-së lidhur me organizimin e punës praktike të studentëve nëpër organizata publike dhe kompani private.
- Marrëveshjet e bashkëpunimeve me subjekte të vendit për realizimin e projektit Tempus “GEO BIZ”
- Marrëveshja me KRU Prishtina, lidhur në mars 2021 për realizimin e praktikës për studentët e programeve studimore nga Hidroteknika.

Projektet ku FN-ja merr pjesë gjatë vitit 2021:

- ✓ ERASMUS + PROGRAMME-KEY ACTION 2-CAPACITY BUILDING IN HIGHER EDUCATIONS: cofound by- Erasmus + Programme of EU. Ndërsa emri i projektit: “HIGHER EDUCATION-ENTERPRISE PLATFORM FOR FOSTERING, MODERNIZATION AND SUSTAINABLE GROWTH IN NATURAL STONE INDUSTRY IN WESTERN BALKANS-BKSTONE”. Vlera e përfitimit të FN-së nga projekti është 35.958,41€
- ✓ Projekti “Erasmus+GEOBIZ, Business driven problembased learning for academic excellence in geoinformatics (no: 601225-EPP-1-2019-1-HR-EPPKA2-CBHE-JP)”. Nga ky projekt Fakulteti i Ndërtimtarisë përfiton përveç tjerash edhe pajisjet – instrumentet Gjeodezike me qëllim të avancimit të mësimdhënies dhe rritjes së kapaciteteve të laboratorëve dhe zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve nga Departamenti i Gjeodezisë përkatësisht programeve të studimeve BSc dhe MSc Gjeodezi. Vlera e përfitimit të FN-së nga projekti është 29.690,00€

Janë përgatitur aplikime në projektet ndërkombëtare për hulumtime shkencore, ngritje të kapaciteteve të stafit të FN-së dhe përmirësimin e infrastrukturës, sikur:

- ✓ Horizon Europe, European Commission, Call HORIZON-WIDERA-2021-ACCESS-02, “Strengthening the Research Capacity in Remote Sensing for Sustainable Management of Land and Water”
- ✓ USAID/KOSOVO, Notice of Funding Opportunity (NOFO) Request for Concept Papers under Request for Applications (RFA) No. 72016722RFA00002. Activity title: Private Sector Partnerships to Strengthen Higher Education

Aspekte financiare në FN:

- Realizimi i kontratës së renovimit të objektit të Fakultetit, niveli 400. Buxheti është i përbashkët nga tri fakultetet teknike (FN, FIEK dhe FIM) në vlerë 210,000.00€ Kontrata është e nënshkruar në dhjetor dhe një pjesë e madhe e punëve janë realizuar brenda dhjetorit. Kontrata e nënshkruar nga operatori është në vlerë prej 175,990.90€ Pritet që projekti të përurohet në filli të vitit 2022.
- Laboratori i Hidroteknikës i cili pajiset me pajisje për nevojat e studentëve dhe shuma e kontraktuar është 54,968.85€
- Laboratori i materialeve me pajisje të nevojshme për studentët në shumë prej rreth 15,444.77€


- Projekti i fituar i FN për programin e studimeve MSc në MIRU (IWRM) në vlerë prej 150,000.00€
- Donacione për FN nga kompanitë vendore, materiale konkretizimi, qasje në platforma elektronike për nevojat e gjeodezisë, shërbime të ndryshme në printime, transporte, shërbime teknike – dyer, ngjyrosje etj. në vlerë të përafërt rreth 15,000.00€

Programet e studimeve – akreditimet dhe riakreditimet e tyre.

E veçantë e aktiviteteve të Fakultetit për këtë vit ishte çështja e riakreditimit të programeve të studimeve. Gjithsej 5 programe të studimeve të cilat riakreditoreshin (BSc –Konstruktiv, BSc Hidroteknikë, BSc Gjeodezi, MSc Konstruktiv dhe MSc Hidroteknikë). Raportet e Vetëvlerësimit të Brendshëm për të gjitha programet e studimeve ishin të përgatitura nga FN-ja. Për arsye të pandemisë, vizita e ekspertëve për hartimin e raporteve të jashtme të vlerësimit u realizua në mënyrë virtuale. Takimet me ekspertët e jashtëm për riakreditimin e programeve u organizuan në dy ditë të ndryshme. Për programin e studimeve BSc Gjeodezi takimet u organizuan me 19 mars 2021, për programet BSc dhe MSc Hidroteknikë me 30 mars 2021 si dhe për programet e studimeve BSc dhe Msc konstruktiv 23 prill 2021.

Me vendimin e Agjencionit të akreditimit nr 3020/21 të datës 12 gusht 2021, të gjitha programet e studimeve të FN-së riakreditoohen sipas kësaj radhitje dhe kohe:

- Programi i studimeve BSc Gjeodezi – 5 vite (2021/2022 deri në 2025/2026)
- Programi i studimeve BSc Konstruktiv – 3 vite (2021/2022 deri në 2023/2024)
- Programi i studimeve MSc Konstruktiv – 3 vite (2021/2022 deri në 2023/2024)
- Programi i studimeve BSc Hidroteknikë – 3 vite (2021/2022 deri në 2023/2024)
- Programi i studimeve MSc Hidroteknikë – 3 vite (2021/2022 deri në 2023/2024)



Grafiku 3. Programet e studimeve të FN-së të riakredituara në vitin 2021

Sipas vendimit të AKA-së, me deri me 15 Nëntor 2021 është dorëzuar plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga ekspertët e jashtëm.

Gjatë kësaj periudhe të këtij raporti FN-ja ka zhvilluar përgatitjet e raporteve të vetëvlerësimit (RVV) të programeve të studimeve BSc Inxhinieri e Ambientit si dhe MSc Gjeodezi për riakreditim në vitin 2022.

Kriteret – standardet e reja të Agjencionit të Akreditimit të Kosovës, përkatësisht Këshillit Shtetërorë të Cilësisë për akreditimin dhe riakreditimin e programeve të studimeve do të jenë sfiduese për programet e organizuara nga FN për periudhën e ardhshme të akreditimeve përkatësisht riakreditimeve. Brenda FN-së organizohen 4 programe BSc dhe 3 programe MSc

Viti 2021 shënon 60 vjetorin e punës së Fakultetit të Ndërtimtarisë. Për rastin e decenies jubilarë të punës së Fakultetit me 19 dhjetor, janë organizuar aktivitete të ndryshme tryezë pune, përrurim i librit universitar si dhe ndarje të mirënjohjeve për personelin akademik In Memorien, të pensionuarit, stafit akademik me mbi 25 vite pune, administratës si dhe Studentëve të Dalluar.

Sipas statistikave të Task Forcës, pjesa më e madhe e stafit akademik dhe administratës së Fakultetit e kanë kaluar infektimin me Covid-19 ndërsa të gjithë janë të vaksinuar me dy vaksinat anti Covid. Në shtator të 2021, si rezultat i Covid 19 vdes njëri nga mësimdhënësit e rregullt të FN-së. Si rezultat i vdekjes së profesorit, FN-ja në pajtim me Rektoratin dhe vendimin e Senatit angazhon Profesor Vizitor nga Universiteti Politeknik i Tiranës, përkatësisht Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit.

Duke u mbështetur në Statutin e UP-së, mbi organizimin dhe funksionalizimin e Trupës Këshillëdhënëse (Bordit Industrial) të njërive akademike, Fakulteti i Ndërtimtarisë rifillon punën për funksionalizimin e të njëjtit. Me 21 maj 2021, organizohet takimi për funksionalizimin e BI të FN-së ku është zgjedhur kryesia (e përbërë nga Kryetari Afrim Demiri, zv Kryetari Sabri Zylfiu dhe Sekretari Mimoza Kurteshi) si dhe 17 anëtarë të BI të përfaqësuar nga Institucionet e vendit, ndërmarrje dhe kompani private.

Gjatë periudhës së këtij raporti kryesia e BI mbanë takime në baza të rregullta mujore me FN si dhe takime me BI në periudha gjashtëmujore. Së bashku me BI, FN-ja organizon ligjërata të hapura sikur: “Projekti i impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura në Prizren-Kadri Selimaj Alb Architect” - mbajtur me 29.10.2021; “Quo vadis INSPIRE – prof.Dr.Vlado Cetl -Kroaci” – mbajtur me 10.12.2021. Janë dy tryeza pune të organizuara nga BI dhe FN-ja. Me 22 shtator 2021 organizohet tryezë pune për ligjin e Odave të Inxhinierëve dhe Arkitektëve të Kosovës, ndërsa me 19 dhjetor 2021 organizohet tryezë pune lidhur me temën “shpronësimi, sfidat dhe zgjidhjet”.

Kontributi i BI-së të FN-së është i konsideruar duke numëruar edhe mbështetjet për nevojat urgjente të FN-së për funksionimin e pa penguar në proceset e mësimdhënies sikur është sigurimi i donacioneve: 18 videoprojektor për të gjitha sallat e mësimit në vlerë rreth 5.000,00€ 4 qasje në sistemin nacional të GPS RKS CORS të cilët mund të përdoren përmes pajisjeve të departamentit të gjeodezisë (vlera 4x400x5=8.000,00€), donacione tjera të cilat janë hartimi i projektit për renovimin e objektit të Fakulteteve (FN, FIEK dhe FIM), largimin – pastrimin e objektit nga mbeturinat, etj. Është shumë premtuese se kjo punë e BI së bashku me FN do të vazhdoj duke u intensifikuar edhe më shumë.

Bazuar në relacionet e krijuara ndërmjet Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe kompanisë përpiluese të Programit softverik DIANA FEA, gjatë dhjetorit janë organizuar trajnime (5 module) për këtë program, i cili është program shumë i avancuar sa i përket fushave të Ndërtimit përkatësisht konstruksioneve. Trajnimi është organizuar online, për 20 (njëzet) studentë dhe 7 (shtatë) pjesëmarrës prej stafit akademik nga Fakulteti jonë. Pas përfundimit të trajnimeve për të gjithë pjesëmarrësit janë dhënë Certifikata të trajnimit.

Në periudhën e fundit të vitit 2021 (Nëntor, Dhjetor) në bashkëpunim me Bibliotekën Kombëtare të Kosovës është organizuar skenimi i të gjitha librave amë - regjistrave të studentëve duke i përfshirë të gjithë librat dhe duke krijuar bankën e shënimeve elektronike të Studentëve të FN-së.


Organizimi i takimeve kolegjiale, mbledhjet e këshillit të fakultetit të Ndërtimtarisë janë organizuar duke respektuar Statutin e Universitetit së paku një takim brenda një muaji. Takimet e komisionit të studimeve janë të rregullta dhe në funksion të kërkesave nga studentët. Takimet e Departamenteve me menaxhmentit të Fakultetit janë në funksion të

kërkesave të tyre dhe me baza të rregullta. Gjithashtu, pjesëmarrja e Dekanit në takimet e kolegjiut të Dekanëve dhe Senatit janë të rregullta. Takimet e menaxhmentit të Fakultetit me Bordin Industrial të Fakultetit janë të rregullta dhe periodike në çdo muaj.


Studentët

Numri i studentëve aktiv në nivel të fakultetit për të gjitha programet e studimeve të niveleve BSc dhe MSc janë 1238.

Numri i studentëve të ri për të studiuar në programet e studimeve të Fakultetit të Ndërtimtarisë është në rënje krahasuar me vitet paraprake. Pranimi i studentëve të ri për vitin akademik 2021/2022 në të gjitha programet e studimeve në nivelin Bsc janë 168 student dhe programet e studimeve MSc janë 78 student. Kapaciteti i programeve të studimeve për studentë të ri në të gjitha programet e studimeve është 370 student, ndërsa të regjistruar për vitin akademik 2021/2022 janë gjithsej 266.



Grafiku 4. Numri i studentëve të FN-së të pranuar në pesë vitet e kaluara për studime në programet e studimeve BSc



Grafiku 5. Numri i studentëve të FN-së të pranuar në pesë vitet e kaluara për studime në programet e studimeve MSc

Për studentët e diplomuar, Alumni është krijuar bazë e shënimeve të tyre përmes pyetësorit të postuar në faqen elektronike të fakultetit dhe vazhdon edhe më tutje të plotësohet nga studentët e diplomuar.

Janë disa raste të mobilitete të studentëve nga Fakulteti i Ndërtimtarisë në institucionet Evropiane, sikur: Universiteti i Trentos, Itali; Universiteti Teknik i Munihut, Gjermani; “Poznan University of Life Sciences” Poloni; Universiteti i Gentit, Belgjikë.

Studentëve të Fakultetit ju është dhënë hapësirë në faqen elektronike të Fakultetit. Janë evidencat e Studentëve transparente të përfaqësimeve të studentëve nga Këshilli i Studentëve, përfaqësues të studentëve në Këshillin e Fakultetit, Studentët e dalluar, Puna e studentëve, Punimet e diplomave Master të Studentëve, etj.

Puna e FN me palën e tretë

Në bashkëpunim me Fakultetin e Arteve, me mësime dhe studentë është realizuar vepra e artit – Murali me motive të fushave Teknike – Abstrakte derisa për furnizimin me materiale janë dhënë donacione në shumë prej 3.000,00€

Stafi akademik i FN-së ka qenë i angazhuar në shërbime profesionale për palën e tretë, përkatësisht institucioneve gjyqësore të Kosovës duke bërë vlerësime dhe ekspertiza profesionale. Janë gjithësej 8 lëndë gjyqësore për të cilat janë përcaktuar mësime dhe ekspertiza profesionale. Janë gjithësej 8 lëndë gjyqësore për të cilat janë përcaktuar mësime dhe ekspertiza profesionale. Janë gjithësej 8 lëndë gjyqësore për të cilat janë përcaktuar mësime dhe ekspertiza profesionale. Janë gjithësej 8 lëndë gjyqësore për të cilat janë përcaktuar mësime dhe ekspertiza profesionale.